



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SILVIKULTURË”

Niveli IV në KSHK¹, referuar niveli IV të KEK²

S1-IV-16

Tiranë, Dhjetor 2016

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Silvikulturë”			Kodi
	Kohëzgjatja	Niveli	IV KSHK, referuar niveli IV të KEK	
	1900-2100 orë			S1-IV--16
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Silvikulturë” niveli IV-të në KSHK, referuar niveli IV të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim teknik i mesëm për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me pyjet. , si dhe “zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon. Zhvillimi të <i>individit</i> i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe një shkallë të gjerë njohurish profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Silvikulturë” niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar dy vitet e para të arsimit profesional në kualifikimin “Pyje”, niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK ose të përafërta me të. – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitet reale të këtyre shkollave, atëherë institucionet përgjegjëse përgatitin udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Silvikulturë”, niveli IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, e pajis individin me Certifikatë Profesionale dhe Supplementin përkatës, të teknikut të mesëm në këtë fushë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si teknik mesëm i profilit Pyjor.</p> <p>Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose familjar në fushën e fidanishteve pyjore, kultivimit të luleve, prodhimeve të dyta të pyllit, trajtimit të pyjeve dhe gjahut, mbrojtjen e tokës nga gërryerjet. Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Nuk ka			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Sipërmarrja dhe organizimi

- Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit në kontekstin e globalizimit;
- Të përshkruajë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet bazë financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare);
- Të shpjegojë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti për një sipërmarrje të vogël;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të ilustrojë metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të përshkruajë metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimin të aftësive profesionale;
- Të shpjegojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të shpjegojë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit), duke u përqendruar në mënyrën e drejtimit, integritit, motivimit dhe mbikëqyrjes së tyre;
- Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në biznes;
- Të shpjegojë dobinë e marketingut në biznes;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të shpjegojë konceptet dhe mjetet e nevojshme për të sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit për vendim-marrjen në biznesin.

Silvoteknika

- Të përshkruajnë teknikat e zbatimit të prerjeve kulturele në pyje;
- Të listojë fazat e zhvillimit të pyllit për çdo etapë zhvillimi;
- Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes të intensitetit të prerjeve kulturele në pyje;
- Të përshkruajë materialin drusor të dalë nga prerjet e kulturave;
- Të listojë format e qeverisjes së pyjeve dhe trajtimet për çdo formë qeverisje;
- Të listojë metodat e shndërrimit në pyje (konversioni);

Mbarështim pyjesh dhe kullotash

- Të shpjegojë parimet bazë të mbarështimit të pyjeve dhe elementët tekniko-ekonomik të mbarështimit;

- Të përshkruajë shenjat kufitare te ekonomive pyjore, ngastrave dhe nën/ngastrave pyjore;
- Të rendisin kriteret e ndarjes së ekonomisë pyjore në parcela dhe nën/parcела;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të sipërfaqeve prove (të përhershme/ përkohshme) dhe regjistrimi i të dhënave;
- Të shpjegojë shfrytëzueshmërinë në pyje dhe format e saj;
- Të përshkruajë ciklin e prodhimit të grumbullit pyjor;
- Të rendisë elementet kryesor për hartimin e një plani të integruar mikrobazeni;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe vlerat e kullotave natyrore, llojshmërinë e florës dhe vlerat ushqyese të barit të kullotave;
- Të listojë masat që duhen marrë për rritjen e prodhimtarisë dhe cilësisë së barit në kullota
- Të klasifikojë kullotat sipas periudhës së përdorimit;
- Të përshkruajë rrugët e rritjes së efektivitetit të kullotave dhe veprat ujëpirëse;
- Të shpjegojë sistemet e ndryshme të kullotjes dhe infrastrukturën e nevojshme;

Ligjshmëria pyjore

- Të shpjegojë bazën ligjore mbi funksionet dhe përgjegjësitë e shërbimit pyjor;
- Të përshkruajë format e pronësisë: pyjet/kullotat publike, fondin pyjor/kullosor privat dhe pyjet me status të veçantë mbrojtje.
- Të shpjegojë sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, (SRPP) bazën dhe dokumentacionin kryesor të pyjeve dhe kullotave;
- Të përshkruajë aktet nënligjore kryesore mbi pyjet, faunën, ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit;
- Të përshkruajë legjislacionin mbi ujerat e peshkimit, faune dhe ushtrimin e gjuetisë;
- Të përshkruajë dokumentacionin e veprimtarisë kontrolluese të policisë pyjore;
- Të përshkruajë rregullat e dokumentimit të shkeljeve dhe dëmtimeve që shkaktohen në fondin pyjor/kullosor, si në rastin e dëmtimit nga zjarret;
- Të përshkruajë legjislacionin e punës dhe kodin e etikës në punë;

Gjeodezi dhe planifikim territori

- Të shpjegojë bazat teorike, metodat, pajisjet dhe instrumente e thjeshtë të matjes së distancave, këndeve, disniveleve dhe pjerrësive në hapësirë;
- Të shpjegojë elementet e hartës topografike dhe imazhet satelitore;
- Të shpjegojë bazën e regjistrimit dhe përditësimit të fondit pyjor/kullosor (Kadastra pyjore /kullosore);
- Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të integruar dhe metodat kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të peizazhit natyror;
- Të shpjegojë planifikimin dhe zhvillimin e pyjeve urban dhe parqeve në zonat e banuara (qytete apo fshatra të dendur me popullsi);

Pyllëzime dhe mbrojtje e tokës

- Të shpjegojë radhën e punës në zbatimin një projekti pyllëzimi dhe mbrojtjen e tokës nga gërryerjet;
- Të listojë llojet më të përdorshme për pyllëzime në mbrojtjen e tokës nga erozioni;
- Të listojë llojet kryesore që përdoren për sistemet agro-pyjore dhe brezat e gjelbër mbrojtës;

- Të shpjegojë mënyrat e punimit të tokës në pyllëzime;
- Të përshkruajë mënyrat dhe kohën e mbjelljes së farës në pyllëzime me farë;
- Të përshkruajë mënyrat, vendosjen, numrin dhe kohën e mbjelljes në pyllëzimet në fidana;
- Të përshkruajë praktikatat e një silvikulture intensive, duke pyllëzuar me fidanë me rritje shumë të shpejtë, për prodhim lënde dhe biomase;
- Të shpjegojë teknikat e pyllëzimeve në zona të ndryshme (toka të rrëshqitshme, zona bregdetare, zona të gjelbërta etj.);
- Të shpjegojë zbatimin e projektit të sistemimeve malore të një mikrobases;

Florikultura

- Të përshkruajë kushtet për rritjen dhe zhvillimin e luleve në mjedise të hapura dhe banimi;
- Të shpjegojë llojet e shumëzimit të tyre;
- Të listojnë llojet e luleve sipas jetëgjatësisë (një, dy dhe shumëvjeçare)
- Të përshkruajë shërbimet kryesore në lultari;

Teknologjia e shfrytëzimit pyjor

- Të përshkruajë rëndësinë dhe qëllimin e shfrytëzimit pyjor;
- Të shpjegojë procesin teknologjik të prodhimit të lëndës në pyll dhe fazat e tij;
- Të listojnë asortimentet të cilat nxirren nga shfrytëzimi i pyjeve;
- Të përshkruajë mënyrat e transportit të brendshëm që përdoren në shfrytëzimin pyjor;
- Të shpjegojë kuptimin e transportit të brendshëm në procesin e prodhimit të shfrytëzimit të pyjeve;
- Të shpjegojë strukturën e shfrytëzimit të pyllit sipas proceseve teknologjike;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së sipërfaqeve të skelave dhe shesheve të stivimit të përkohshëm të materialit drusor;
- Të analizojë humbjet gjatë fazave të procesit teknologjik të shfrytëzimit;
- Të përshkruajë llojshmërinë e prodhimeve që dalin nga shfrytëzimi i pyjeve dhe kushtet teknike të tyre;
- Të listojë rregullat e sigurimit teknik në punë gjatë organizimit të punës për prerjen, transportin dhe ngarkimin e materialit drusor;
- Të shpjegojë teknikën e vjeljes, manipulimit dhe ruajtjen e prodhimeve të dyta pyjore;
- Të shpjegojë teknikën e nxjerrjes së esencave nga llojet drusore dhe barishtore;
- Të përshkruajë mënyrën e plotësimit të dokumentacionit shoqëruar të lëvizjes së materialit drusor;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Sipërmarrja dhe organizimi

- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
- Të plotësojë dokumentacionin e lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve, dhe veprimeve kryesore me bankën;
- Të plotësojë regjistra të ditëve të punës dhe pagesave;
- Të plotësojë akt-marrje të punimeve dhe hartimin e situacioneve;

- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës;
- Të hartojë një plan të thjeshtë për një biznes që mund të zhvillohet me bazë në pyje dhe kullota;

Silvoteknika, mbarështrimi dhe kullotë pyjore

- Të përcaktojë llojin e prerjeve kulturore në varësi të fazës së zhvillimit të pyjeve;
- Të përcaktojë drurët që do të hiqen gjatë prerjeve kulturore;
- Të vlerësojë materialin drusor të dalë nga prerjet kulturore;
- Të llogarisë intensitetin e prerjeve kulturore;
- Të përcaktojë kriteret e ndarjes së ekonomisë pyjore në parcela dhe nënparcela;
- Të vendosin shenjat kufitare sipas pronësisë së pyjeve;
- Të plotësojë formularët e përshkrimit parcelar;
- Të plotësojë evidencat të punimeve të kryera gjatë zbatimit të planeve të mbarështimit;
- Të zbatojë metodat e matjes në pyje në varësi të formës së qeverisjes;
- Të nxjerrin të dhëna nga planet e mbarështimit;
- Të zbatojë projektet për punimet e përmirësimit të kullotave;
- Të ndërtojë lera të thjeshta sipas projektit;
- Të organizojë sisteme të ndryshme të kullotjes;
- Të përcaktojë rregullat e shtegtimin të kafshëve;
- Të përdorë pajisjet vetjake dhe veshjet që duhet të mbajë gjatë punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknikë dhe të shëndetit në punë;

Gjeodezi dhe planifikim territori

- Të kryejë matje me instrumente të thjeshtë matës gjeodezie;
- Të përcaktojë metodat e nivelimeve dhe instrumentet përkatës që përdoren;
- Të kryejë matje të sipërfaqeve pyjore dhe jo pyjore me teodolit dhe nivelues;
- Të plotësojë tabelat e nivelimit dhe të matjeve me teodolit,;
- Të lexojë latën në pikat e poligonit;
- Të hedhë në planshet të dhënat e grumbulluara;
- Të realizojë në klasë mbylljen e poligonit;
- Të plotësojë të dhënat për përditësimin e kadastrës pyjore dhe kullosore;

Pyllëzime artificiale

- Të piketojë me mjete të thjeshta një sipërfaqe të zhveshur për pyllëzim sipas formulave dhe skemave të pyllëzimit të parashikuar në projekt;
- Të zbatojë përmasat e hapjes së gropave, ndërtimit të shesheve dhe gradonave;
- Të përcaktojë cilësinë e fidanëve në pyllëzime, sipas standardit e fidanëve;
- Të kryejë shërbimet kulturore në pyllëzimet artificiale;
- Të inventarizojë fidanët, sipas udhëzimeve, në fidanishte dhe pyllëzime për llogaritjen e përqindjes së zënies.

Florikultura

- Të kultivojë lulet një dhe shumëvjeçare;
- Të kryejë shumëzimin e bimëve me farë dhe në mënyrë vegjetative;
- Të kryejë shërbime dhe punime në lultari;
- Të hartojë një projekt gjelbërimi në sipërfaqe të vogla;

- Të zbatojë një projekt gjelbërimi në sipërfaqe të vogla;

Teknologjia e shfrytëzimit pyjor

- Të zbatojë skemën teknologjike të shfrytëzimit të parcelës, duke njohur planin tekniko-ekonomik të shfrytëzimit;
- Të organizojë brigadën komplekse të shfrytëzimit të pyllit dhe radhën e punës në shfrytëzimin e ngastrave pyjore;
- Të përdorë instrumentet dhe makineritë për rrëzimin e përpunimin e parë në pyll të drurit dhe mirëmbajtjen e tyre;
- Të kryejë asortimin e drurit të rrezuar dhe transportin e brendshëm, sipas skemës teknologjike;
- Të kryejë ngarkimin e lëndës drusore me vegla dore apo me mekanizma të thjeshtë;
- Të zbatojë të gjitha rregullat e sigurimit teknik gjatë gjithë fazave të procesit teknologjik të shfrytëzimit gjatë: prerjes, asortimit, transportit të brendshëm, depozitimit dhe ngarkimit të lëndës drusore;
- Të plotësojë dokumentacionin e lëvizjes së materialit drusorë sipas rregullave dhe kërkesave të përcaktuara;
- Të shpjegojë mënyrat e nxjerrjes së esencave nga disa lloje drusore dhe barishtorë;
- Të kryejë hapjen e rrugëve të lëvizjes së punëtorëve, kafshëve të ngarkesës dhe mekanizmave që nevojiten për transportin e brendshëm të lëndës drusore, ndërtimi i lugjeve, ndërtimi i skelave të ngarkimit dhe shesheve të depozitimit të drurit;
- Të zbatojë të gjitha rregullat dhe të marrë masat e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri të mjeteve dhe mekanizmave, materialit drusor dhe ngastrës pyjore ku shfrytëzohet.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknikë, të mbrojtjes dhe shëndetit në punë;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

